

VENDIM
Nr. 543, datë 18.6.2015

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA
MINISTRIA E MBROJTJES, MINISTRISË SË ENERGJISË DHE INDUSTRIISË, PËR
SHËRBIMIN GJEOLGJIK SHQIPTAR, TË NJË OBJEKTI DHE TË TRUALLIT
FUNKSIONAL, BRENDA TERRITORIT TË PRONËS NR. 6, ME EMËRTIM
“INSTITUTI GJEOGRAFIK I USHTRISË”, ME VENDNDODHJE NË RRUGËN
“MYSLYM KETA”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, të neneve 901 e vijues, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, nga Ministria e Mbrojtjes, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, për një periudhë 35-vjeçare, të një objekti 3-katësh dhe të truallit funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 5 000 (pesë mijë) m², brenda territorit të pronës nr. 6, me emërtim “Instituti Gjeografik i Ushtrisë”, me vend-ndodhje në rrugën “Myslym Keta”, Tiranë, sipas planvendosjes dhe planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, për t’u përdorur për sistemimin me ambiente pune, në funksion të veprimtarisë së administratës së Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.


2. Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e objektit dhe të truallit funksional, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

3. Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar të nxjerrin aktet e nevojshme për dhënien në përdorim të përkohshëm të objektit dhe të truallit funksional, sipas pikës 1, të këtij vendimi, duke përcaktuar detyrimet për secilin institucion.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Energjisë dhe Industrisë, drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe krye-regjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama




PUNOI
TOPOGRAF NIKOLL TUSHI

SHKALLA 1 : 1000

DREJTORI I IGJËU
N/KOLONEL ZYDI ALCANI




PLANIMETRIA E OBJEKTIT NR 6 KATI PERDHE
SHKALLA 1/150
SIP 609 m2




REP. SHQIPERISE MIN. ERIKUTIA EDUKATIONES	DIREKTOR	ING. Z. ALI DANI
LOJTI	UZATET	Ing. A. BLI
	PROJEKTOR	Ing. A. BLI
	KONTROLLOR	Ing. K. HISEMI

PLANIMETRIA E OBJEKTIT NR 6 KATI I PARE
SHKALLA 1/150
SIP 609 m2



REF SHIPSPENSE AND REPAIRS (GULU)	DIRECTIONS	LOCAL TRAIL ACCOUNT
	MAZATO	Map A, B/L
	PERFLO	Map A, B/L
	KONTROLLO	Map K, HYPER

PLANIMETRIA E OBJEKTIT NR 6 TARACA
 SHKALLA 1/150
 SUPERFAQJA E PAPAFINGOS 37.7 m2
 SUPERFAQJA E PËRGJITHSHME 609 m2



REP. SHQIPËRIE MIN. BASHKËVARRËSIA LOJTI	DREJTORI	INZ. D. ALCANT.
	VEDATI	Kap. A. BILI
LOJTI	PENALI	Kap. A. BILI
	KONTROLLO	Ing. K. HYSENI

